Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	**04.11.2024**	**11.11.2024**	**2024/1031**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.10.2024, **OE "Sodex Group SH.P.K**."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/1031, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "TDT KOSOVA SH.P.K."-** Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME ÇELËSA PËR PRANGA" me nr. të prokurimit: "214-24-9135-1-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kuotimit te çmimeve, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **3,500 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e LPP-së që jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit te ofertave janë:

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt.17.09.2024, kurse hapja e ofertave është bërë me dt.23.09.2024.

Njoftimi mbi vendimin është nxjerr me dt.10.10.2024, ku është rekomanduar për kontratë OE "TDT Kosova" me çmim prej 3,150.00 euro, ndërsa ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Ne kemi pas qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtur se oferta e këtij OE është e papërgjegjshme administrativisht dhe teknikisht.

• OE i rekomanduar për kontratë me dosje nuk ka ofruar deklaratë për garancionin e produkteve.

• OE i rekomanduar për kontratë me dosje nuk ka ofruar deklaratë për afat te liferimit.

Përveç pjesës administrative OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar edhe anën teknike përkatësisht specifikimet teknike përkitazi me mostrat e ofruara.

• Tek specifikimet teknike është kërkuar: Çelësi duhet të jetë i gjatë 45 mm -0.3mm, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çelës me gjatësi 48.45mm, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka prezantuar çelsin me dimensionet e kërkuara.

• Tek specifikimet teknike është kërkuar: Rrethi i brendshëm i çelësit duhet të jetë F8.9 mm, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çelës me 8.3mm, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.

• Tek specifikimet teknike është kërkuar: Rrethi i jashtëm i çelësit duhet të jetë F15.9 mm, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çelës me 15.72mm, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.

Nga argumentet tona të lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk ka ofertuar konform kërkesave dhe specifikimeve teknike të dosjes së tenderit, andaj i njëjti është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerr me d.16.10.2024, ku është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, ndërsa është lënë në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Në përgjigje autoriteti kontraktues ka thënë se mostra e OE të rekomanduar për kontratë i plotëson specifikacionet teknike dhe kinse ditën që kemi pas qasje noniusi nuk kishte punuar mirë për shkak se bateria ishte dobësuar.

Tek vendimi për refuzim është vendosur një foto ku shihet që rrethi i brendshëm i çelësit është 8.09 mm dhe këtë matje e ka bërë AK-së.

Nga kjo dëshmi vërtetohet dhe dëshmohet se nuk është plotësuar specifikacioni në

mostrën e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku AK-së me mjetet e veta matëse ka ardh në përfundim se rrethi i brendshëm i çelësit është 8.09. Sa për sqarim, kërkesa ka qenë që rrethi i brendshëm i çelësit është të jetë F8.9 mm. Pra 8.09 me 8.9 ka dallim dhe nuk është e njëjtë siç ka pretenduar AK-së.

Në foton tjetër shihet që rrethi i jashtëm i çelësit është F 15.9 mm, mirëpo ne nuk e dimë se si dhe kur është bërë kjo matje, pasi që ne gjatë qasjes në dokumente kemi bërë matjet dhe ka rezultuar se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çelës me 15.72mm.

Sa i përket gjatësisë së çelësit, autoriteti kontraktues është përgjigjur si më poshtë:

Pra kërkesë e dosjes ka qenë që çelësi duhet të jetë i gjatë 45 mm -03mm, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çelës me gjatësi 48 mm dhe këtë e konfirmon vetë AK-së dhe njëkohësisht pretednon se ka ofertuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Ky konstatim i AK-së, është plotësisht i pasaktë, sepse 48 mm nuk hyn në kuadër të gjatësisë

45 mm -03mm, sepse nëse 45 mm i shtohet 0.3 mm atëherë gjatësia bëhet 45.30 mm e jo 48 mm siç pretendon AK-së, prandaj analiza dhe matja e AK-së është e pasaktë, gje qe e bene kete tolerance 10 here me te madhe se sa ajo e kërkuar ne specifikat tekniken.

Nga këto përgjigje të AK-së vërtetohet saktë dhe qartë papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në këto dëshmi që tregojnë mangësi të mëdha të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, atëherë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme.

Në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Nuk është respektuar edhe neni i 7 i LPP-së, duke u diskriminuar ne si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 dhe neni 6 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të

fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa në këtë rast është vepruar në kundërshtim me këto dispozita, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

I. APROVOHET e bazuar ankesa e OE "Sodex Group SH.P.K për Lot 2.

I. ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së B58 për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM

II. DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		**a) Mostra -një çelës**	**a) Sjellja e mostrës para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit për të gjithë artikujt – obligative para orës 14 00 h**
Siguria e ekzekutimit		**Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është10 % e vlerës se kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 45 ditë kalendarike**	
			Çelësi duhet të jetë i përshtatshëm për hapjen e prangave të modelit Alcyon 5010 Çelësi duhet të jetë në gjendje të bëjë bllokimin e dyfishtë për prangat Alcyon 5010

			Çelësi duhet të jetë i gjatë 45 mm +-0.3mm Rrethi i brendshëm i çelësit duhet të jetë Φ8.9 mm Rrethi i jashtëm i çelësit duhet të jetë Φ15.9 mm Çelësi duhet të jetë me peshë 5gr Çelësi duhet të jetë i prodhuar sipas standardit DIN EN10204

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Në procesverbal, komisioni vlerësues duhet të jep informacione në detaje lidhur me përmbajtjen e secilit tender duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ekzaminimi, vlersimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative: përshtatshmërinë e paanshmërisë: përshtatshmërinë profesionale: gjendjen ekonomike dhe financiare: aftësinë teknike dhe / ose profesionale: përshtatshmërinë teknike:

OE1 .Sodex Group SH.P.K.,Prishtinë , i **plotëson të gjitha kriteret e kërkuara administrative në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, mirëpo çmimi i ofruar është më i lartë se OE tjetër i përgjegjshëm**

OE2. TDT KOSOVA " SH.P.K.,Prishtinë ,Pas kërkesës për sqarime shtesë nga AK bazuar në nenin 59.2 LPP dhe neni 72 te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Operatori Ekonomik është përgjigjur në sqarimet e kërkuara brenda afatit kohor te përcaktuar ne kërkesën për sqarime shtesë pasi që afati i fundit për pranimin e sqarimeve shtesë ka qene data01.10.2024, ora 16:00h, dhe ka ofruar dëshmi çelësi sipas standardit DIN EN10204.

Edh e pse çelësi peshon 4 gr. ndërsa ne specifika teknike pesha e çelësit është kërkuar me peshe 5 gr, po ashtu çelësi kur futet në prang, futet me lehtësi dhe eshte ma i përshtatshëm për hapje te prangave dhe kosto e ofertës është me e ultë se sa OE tjeter I pergjegjshem.

sipas LPP-së **Neni 59**

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Pika 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

- **Sipas kësaj ky OE I plotëson të gjitha kriteret e kërkuara dosjesë tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe çmimi I ofruar është më I ulët se OE tjetër I përgjegjshëm.**

DEKLARATË

të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim

Komisioni I vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitet I prokurimit, konstatojmë se për këtë projekt janë pranuar dy (2) ofertë, komisioni vlerësues rekomandon si ne vijim: t'I jepet kompanisë , TDT KOSOVA " SH.P.K.,Prishtinë sepse I plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në njoftimin për kontratë, dosje të tenderit si ofertë e përgjegjshme me çmim më të ulët .

Informim për vlerësimin e projektit për Furnizim me çelësa për pranga të PK-së.

Duke ju referuar dy Ofertave te pranuara dhe vlerësuar nga ana jone si anëtare te komisionit, gjate vlerësimit tonë japim ketë konkluzion.
Në projektin per Furnizim me çelësa për pranga te PK-së kanë ofertuar dy OE, si me poshtë.

1- OE " SODEX GRUP " Sh. P. K dhe
2- OE " TDT KOSOVA " Sh. P. K.

Sipas vlerësimit nga ana e jonë si anëtar te komisionit për vlerësimin e specifikave teknike japim ketë vlersim.

OE-me nr-1, i plotëson te gjitha specifikat teknike, por çelësi kur te vendoset ne pranga hynë pak me vështirësi, dhe OE ka koston e ofertës me te larte, ndërsa

OE-me nr-2 i plotëson te gjitha specifikat teknike te kërkuara, vetëm te pesha e çelësit ka peshe 4 gr, ndërsa ne specifika teknike pesha e çelësit është kërkuar me peshe 5 gr, po ashtu çelësi kur futet në prang, futet me lehtësi dhe eshte ma i përshtatshëm per hapje te prangave, dhe kosto e ofertës është me e ultë (lirë) se sa OE me nr-1.

Ne si anëtar te komisionit kemi hulumtuar dhe shikuar edhe ligjin e prokurimit, ku ne ligjin në Nenin 59, pika 4 lejon veprimet e njëjta si ne projektin ne fjale.

Ne si anëtarë te komisionit për vlerësimin e projektit ne fjale, Rekomandojmë qe Oferta me nr-2 te jete ofertë e përzgjedhur (fituese), pasi qe pesha e çelësit në specifikacionin e kërkuar, nuk shkakton ndonjë pengese për +- 1 gr më pak ose me shumë.

Me respekt nga
Qamil Mustafa
Xhavit Krasniqi

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Sodex Group SH.P.K.**

Sqarim: Në përputhje me kërkesat e Bordit të OSHP-se eksperti shqyrtues ka vizituar AK-ne me datën 07.11.2024 dhe në prezencë të ekspertit dhe përfaqësuesve te AK-se janë bërë matjet e mostrave.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi I OE ankues ka te beje me afatin e liferimit dhe te garancionit te dhënë me ofertën e OE te rekomanduar për kontrate.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk është i përgjegjshëm administrativisht dhe teknikisht sepse ne oferte nuk ka ofruar deklarate për garancionin e produkteve dhe nuk ka ofruar deklaratë për afat te liferimit.

Eksperti shqyrtuesduke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit sqaron se me FDT nuk është kërkuar ne mënyrë specifike qe te dorëzohen deklarata për garancinë dhe liferimin e mallrave.

OE i rekomanduar ne formularin për dorëzimin e tenderit specifikohet ne piken 1 dhe 2:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 FURNIZIM ME ÇELËSA PËR PRANGA

3. Çmimi total i tenderit është:

3,150.00 EUR

Prandaj duke u bazuar ne kërkesat e FDT-se dhe deklaratat ne formularin e dorëzimit te tenderit eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate ka vepruar sipas kërkesave te dosjes se tenderit dhe se formulari i dorëzimit te tenderit e plotëson kërkesën e Nenit II.6 dhe II.7 dhe **rrjedhimisht pretendimi ankimor nuk është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin qe ka te beje me Kërkesat e FDT Aneksin 1 është kërkuar:

Çelësi duhet të jetë i gjatë 45 mm +-0.3mm

Rrethi i brendshëm i çelësit duhet të jetë Φ8.9 mm

Rrethi i jashtëm i çelësit duhet të jetë Φ15.9 mm

Çelësi duhet të jetë me peshë 5gr

Eksperti shqyrtues ne përputhje me emailin e OSHP –se te datës 26.03.2024 ka vizituar AK-ne dhe në prani të zyrtarëve të AK-se ka bërë matjet e mostrave sipas kërkesës se FDT-se Aneksi 1 dhe sipas matjeve rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka një dikrepancë më të madhe se të lejuar te gjatësia e mostrës se çelësit dhe diskrepanca me te vogla te parametrat e rrethit te jashtëm dhe te brendshëm.

Vlen të theksohet se gjatë matjeve të mostrave te OE ankues ka rezultuar se i njëjti ka diskrepancë më të madhe se të lejuar me FDT dhe nuk janë në përputhje me kërkesat e FDT-së.

Duke u bazuar ne administrimin e provave, matjet e mostrave te dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues vlerëson se mostrat e dorëzuara nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit Aneksi 1 , rrjedhimisht vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-se si dhe nenin 40.2 dhe 40.6 b) te RRPP 001/2022 dhe se **pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.**

Vlen të theksohet se në këtë aktivitet të prokurimit të dy ofertat e dorëzuara nuk janë në përputhje me dispozitat e nenit 40.7 te RRPP 001/2022.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet aktiviteti i prokurimit ne tërësi dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Sodex Group SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Burim Zeka